



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, me 07 prill 2022, në orën 17:20

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Doarsa Kica – Xhelili, Mergim Lushtaku, Fidan Jilta, Valon Ramadani, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi, Isak Shabani, Besnik Tahiri.
Munguan: Agim Veliu dhe Igor Simic.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Doarsa Kica -Xhelili, kryetare e komisionit, me këtë:

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin nr.08/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik;**
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin nr.08/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik;**

Doarsa Kica-Xhelili, paraqiti për shqyrtim raportet e komisioneve të përhershme për Projektligjin nr. 08/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët

Publik. Ajo theksoi se komisionet e përhershme nuk kanë paraqitur ndonjë vërjetje për projektligjin e lartëcekur.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 07.04.2022, shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zyrtarët Publik dhe me këtë rast vlerësoi se Projektligji, nuk përmban kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, në mbledhjen e mbajtur më 07.04.2022, shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zyrtarët Publik dhe ka konstatuar se projektligji është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian, në mbledhjen e mbajtur më 07.04.2022, shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zyrtarët Publik dhe vlerësoi se projektligji nuk i cenon parimet bazë të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mungesë kuorumi nuk e shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zyrtarët Publik siç është kërkuar me vendim të Kuvendit.

Meqë nuk kishte vërjetje nga anëtarët e komisionit, kryetarja konstatoi se Komisioni me 8 vota “Për” dhe 1 “Abstenim” nga deputeti Mergim Lushtaku, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të shqyrtohet dhe miratohet Projektligji nr.08/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pa amendamente.

3. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime nga anëtarët e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 17:35.

Kryetarja Komisionit,

Doarsa Kica - Xhelili